

VENDIM
Nr. 687, datë 2.9.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E BLERJES SË
APARTAMENTEVE, QË DO T'IU DHUROHEN FAMILJARËVE TË VIKTIMAVE
SI PASOJË E TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019, NGA BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 18, pika 2, dhe 24, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 28 608 306 (njëzet e tetë milionë e gjashtëqind e tetë mijë e treqind e gjashtë) lekë, për blerjen e 4 (katër) apartamenteve, që do t'iu dhurohen familjeve të viktimave si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019, nga Bashkia Durrës.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi i rindërtimit, pjesa e financuar nga buxheti i shtetit, i miratuar për vitin 2020, dhe i transferohet Bashkisë Durrës, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe